



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE
TË KOMPANISË RAJONALE TË UJËSJELLËSIT
HIDROREGJIONI JUGOR SH. A. PËR VITIN 2021**

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Çështjet e zgjidhura gjatë procesit të auditimit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Shtojca II: Pasqyrat financiare vjetore të audituara

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit Hidroregjioni Jugor sh. a. për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kundërt për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit Hidroregjioni Jugor sh. a. (Kompania), të cilat përmbajnë pasqyrën e pozitës financiare për vitin 2021, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme kontabël, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin “Baza për Opinion të Kundërt”, Pasqyrat Financiare të bashkangjitura nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të pozitës financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellit Hidroregjioni Jugor sh. a. deri me 31 dhjetor 2021, të performancës së saj financiare, si dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin 2021, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion të kundërt

- A1 Mos përputhja e gjendjes në regjistrat kontabël të Kompanisë me gjendjen në Administratën Tatimore të Kosovës në vlerë prej 1,496,887€ për detyrimet ndaj TVSH-së;
- A2 Kompania ndër vite nuk kishte aplikuar një politikë të përshtatshme dhe konsistente të lejimeve të llogarive të arkëtueshme, dhe si rrjedhojë, ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nëse saldo e lejimeve të akumuluar të llogarive të arkëtueshme në vlerë prej 7,496,349€ ishte e saktë. Lejimi për llogaritë e arkëtueshme për vitin 2021 ishte 541,371€;
- A3 Në 18 raste nuk kemi pranuar konfirmimet nga palët e treta për llogaritë e arkëtueshme në vlerën prej 387,560€, për shkak se sipas zyrtarëve të kompanisë, 10 prej tyre nuk ekzistojnë dhe 8 të tjerë kishin refuzuar të kthejnë konfirmimet nën arsyetimin se janë në procese përmbartimore. Më tutje, ne kemi aplikuar procedura alternative të auditimit dhe kemi identifikuar se kishte pasaktësi (nënvlerësim) në prezantimin e këtyre llogarive në shumën prej 178,363€;
- A4 Vlera e të hyrave të shtyra nga grantet e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar 2021 ishte 19,791,975€ ndërsa duke iu referuar shënimeve analitike të vlerës së mbetur të pasurive dhe investimeve në vijim, vlera e përfutur nga grantet ishte 19,833,335€, e cila rezulton me një diferencë prej 41,360€;
- A5 Gjatë vitit 2021 Kompania kishte paguar në emër të taksave ndaj përmbartuesve vlerën prej 27,157€, të cilën në kontabilitet e kishte njohur si të hyrë të vitit, duke shkaktuar mbivlerësimin e të hyrave për të njëjtën shumë;
- A6 Fatura në vlerë 9,370€ që ka të bëjë zbritjet tregtare për shpenzimet për muajin Dhjetor 2021, në kontabilitet nuk ishte regjistruar në periudhën e duhur, por ishte regjistruar me rastin e pranimit në janar 2022;
- A7 Gjatë vitit 2021 për 4 fatura në vlerë 109,176€ të projekteve të financuara nga donacionet, Kompania kishte aplikuar regjistrime të gabuara kontabël duke njohur pjesën e TVSh-së së këtyre faturave si të ardhura të vitit, në vend se e gjithë vlera e faturave të njëjës si detyrim, përkatësisht e hyrë e shtyrë nga grantet. Të ardhurat e vitit ishin mbivlerësuar për 16,654€ dhe njëkohësisht detyrimi ndaj grantit ishte nënvlerësuar për të njëjtën shumë.

Më gjerësisht shih nënkaptullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshtatshme me pjesën e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodin e Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera të Kompania kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë të përshkruara më poshtë të pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit të Përgjithshëm për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10 dhe SNISA 130, si dhe me kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të Ndërmarrjeve Publike dhe Kodit të Etikës të ZKA-së, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keqdeklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë gjithashtu zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime), Ligjit 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

Bordi i Drejtorëve është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh. a..

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh. a. është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit Hidroregjioni Jugor sh. a. në përputhje me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, si dhe të gjitha ligjet, rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.²

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrim një raport të auditimit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është niveli i lartë sigurie, por nuk garanton se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, me arsye pritet që të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra në bazë të këtyre Pasqyrave Financiare.

Objekivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të KRU "Hidroregjioni Jugor" sh. a. me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare. Si pjesë e auditimit, në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-t, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keqdeklarimit material të Pasqyrave Financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit; hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit konform atyre rreziqeve, si dhe sigurojmë dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të duhura për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i moszbulimit të një keqdeklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për keqdeklarimin që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulimin, falsifikimin, lëshime të qëllimshme, keqpërfaqësime apo anashkalimin e kontrollit të brendshëm.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo me qëllim të shprehjes së opinionit për efikasitet të kontrollit të brendshëm të Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh. a..
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura kontabël dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim nëse baza e vijimësisë së kontabilitetit është e përshtatshme për përdorim nga menaxhmenti, bazuar në provat e siguruara të auditimit, nëse ekziston pasiguria materiale në lidhje me ngjarje apo kushte që mund të hedhin dyshime të rëndësishme në aftësinë e Kompanisë Rajonale të Ujësjetës Hidroregjioni Jugor sh. a., për të vazhduar sipas parimit të vijimësisë. Nëse konkludojmë se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet që të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet përkatëse në Pasqyrat Financiare ose, nëse zbulimet e tilla janë të papërshtatshme ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona bazohen në provat e auditimit të marra deri në datën e raportit tonë të auditimit. Sidoqoftë, ngjarjet apo kushtet e ardhshme mund të bëjnë që NP-ja të pushojë së vazhduari sipas parimit të vijimësisë.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e Pasqyrave Financiare, përfshirë edhe shpalosjet, për t'u siguruar se Pasqyrat Financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si sensitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm se deri në çfarë mase ato janë adresuar. Ky raport ka rezultuar me tetë (8) rekomandime të reja.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 3.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja A1 - Mos përputhje e detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël të Kompanisë me gjendjen në ATK

Gjetja

Ligji nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 12, përkatësisht pika 1 përcakton se: Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një (1) herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit. Po ashtu, neni 12, pika 2 ndër tjera përcakton se: Inventarizimi duhet të barazohet me librat kontabël.

Kompania kishte prezantuar në pasqyrën e pozicionit financiar detyrime ndaj Tatimit mbi Vlerën e Shtuar (TVSh-së) shumën 1,496,887€, ndërsa bazuar në gjendjen e përgjithshme të deklarimeve dhe transaksioneve tjera të tatimpaguesit si dhe pas konfirmimit të pranuar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), kompania nuk kishte detyrime për këtë llogari tatimore, përkatësisht gjendja e borxheve ndaj ATK-së ishte zero.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos harmonizimit të detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël për vitet e mëhershme, me gjendjen e deklarimeve dhe borxheve në ATK.

Ndikimi

Mos prezantimi i saktë i zërit financiar për obligimet ndaj TVSh-së reflekton me pasqyrim të gjendjes jo reale (çorientuese) të pozicionit financiar të kompanisë.

Rekomandimi A1

Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme në mënyrë që të identifikohen dhe harmonizohen detyrimet tatimore të kompanisë me gjendjen e llogarive në ATK.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Mungesa e politikave të qarta dhe analizave të mjaftueshme për lejimet ndaj të arkëtueshmeve**Gjetja**

Sipas SNRF 9 Instrumentet financiarë, paragrafi B5.5.35 përcakton: një njësi ekonomike mund të përdorë mjete praktike të volitshme kur mat humbjen e pritshme të kredisë nëse ato janë në përputhje me parimet e paragrafit 5.5.17. Një shembull i një ndihmese të tillë është llogaritja e humbjeve të pritshme të kredisë për llogaritë e arkëtueshme tregtare duke përdorur një matricë provizionesh. Njësia ekonomike do të përdorë përvojën e saj historike të humbjes së kreditit (e rregulluar sipas nevojës në përputhje me paragrafët B5.5.51-B5.5.52), si një praktikë të përshtatshme, për llogaritë e arkëtueshme tregtare për të vlerësuar humbjet e pritshme të kredisë për periudhën 12-mujore ose humbjet e pritshme të kredisë për tërë jetën e aktivitetit financiar. Në varësi të larmisë së klientëve të saj, njësia ekonomike do të përdorë grupimet e përshtatshme në qoftë se përvoja e saj historike e humbjeve të kredisë tregon modele të ndryshme humbjeje për segmente të ndryshme të klientëve.

Nga saldo bruto e llogarive të arkëtueshme (LLA) prej 12,347,325 € lejimet e akumuluarra për LLA deri me 31 dhjetor 2021 ishin 7,496,349€.

Kompania nuk kishte politika të shkruara dhe nuk kishte kryer analiza të mjaftueshme të cilat mbështesin parashikimet e menaxhmentit të bëra në lidhje me saldon e lejimeve të akumuluar të llogarive të arkëtueshme. Vlen të theksohet se lejimi në vlerë prej 541,371€ i LLA për vitin 2021 ishte bërë pa ndonjë analizë të strukturuar të llogarive të arkëtueshme. Prandaj, në mungesë të këtyre analizave, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare prej 4,850,976€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Kompania ndër vite nuk kishte aplikuar një politikë të përshtatshme dhe konsistente të lejimeve të llogarive të arkëtueshme.

Ndikimi

Mos aplikimi i lejimeve të llogarive të arkëtueshme tregtare sipas një analize të qëndrueshme që mat humbjen e pritshme të kredisë mund të sjellë deri te mbivlerësimi material i llogarive të arkëtueshme në pasqyrën e pozitës financiare, apo në rastin e kundërt, në mbivlerësimin e shpenzimeve të borxhit të dyshimtë në pasqyrën të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën. Rrjedhimisht kjo reflekton edhe në pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për periudhën si dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë.

Rekomandimi A2

Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë zbatim të plotë të SNK-ve dhe SNRF-ve në mënyrë që të vendosë një politikë të përshtatshme për lejimet ndaj llogarive të arkëtueshme. Po ashtu, kompania duhet të aplikojë një rishikim gjithëpërfshirës dhe detal të saldosh të llogarive të arkëtueshme për një pasqyrim sa më të drejtë të tyre në pasqyra financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A3 - Pamundësia e konfirmimit të bilanceve të llogarive të arkëtueshme dhe mungesa e dokumenteve burimore për ish ndërmarrjet shoqërore

Gjetja Sipas Ligjit Nr. 06/L- 032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim neni 12 përkatësisht pika 1 përcakton se: Shoqëritë tregtare që i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji, verifikojnë të paktën një herë në vit, ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive, detyrimeve dhe kapitalit, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dëshmive të tyre mbështetëse nëpërmjet procesit të inventarizimit.

Nga 20 konfirmime të kërkuara nga debitorët, janë kthyer vetëm dy (2) sosh në vlerën financiare 26,632€, ndërsa për 18 të tjera në vlerë prej 387,560€ nuk janë kthyer fare konfirmimet. Nga konfirmimet që nuk janë kthyer, në 10 raste në vlerë prej 226,508€, sipas zyrtarëve të kompanisë konsumatorët nuk ekzistojnë ose nuk janë të identifikueshëm, në mungesë të dhënave të sakta, ndërsa për 8 raste të tjera në vlerë prej 161,052€ klientët kanë refuzuar të ta konfirmojnë gjendjen, sepse ato ishin borxhe të vjetra dhe rastet janë në procedura përmbare. Disa prej tyre ishin ndërmarrje shoqërore, të cilat tashmë janë privatizuar. Megjithatë, edhe pse nuk janë kthyer konfirmimet, ne kemi kryer procedura alternative shitesë dhe në dy raste tek ish-ndërmarrjet shoqërore kemi identifikuar mos përputhje në vlerë prej 178,363€ në mes saldos së llogarive të arkëtueshme të prezantuara në pasqyrat financiare (70,548€) dhe dokumenteve burimore (248,911€).

Kjo kishte ndodhur për shkak se kompania nuk kishte bërë procesin e inventarizimit-harmonizimit të gjendjeve me klientë në baza periodike.

Ndikimi Rastet kur klientët nuk ekzistojnë apo mungojnë të dhënat e duhura për ta, si dhe rastet kur klientët refuzojnë të nënshkruajnë konfirmimin, ka ndikuar që kompania të prezantoj gabimisht gjendjen e llogarive në pasqyra financiare. Rrjedhimisht, Kompania mund të mos jetë në gjendje të arkëtojë borxhet e tilla në të ardhmen.

Rekomandimi A3 Bordi i Drejtorëve duhet të sigurojë procedura të harmonizimit periodik të llogarive me debitorët. Për ndërmarrjet shoqërore të cilat janë privatizuar, kompania duhet ta diskutoj çështjen e borxheve të pa paguara me Agjencinë Kosovare të Privatizimit e cila ka administruar procesin e transformimit të pronësisë dhe detyrimeve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A4 - Mos përputhje mes shënimeve në kontabilitet me detyrimet ndaj grantit të prezantuar në pasqyra financiare**

Gjetja Njëra nga metodat e paraqitjes së granteve në kontabilitet sipas SNK 20 Kontabiliteti i Granteve Qeveritare dhe Dhënia e Informacioneve Shpjeguese, paragrafi 26 nje grantin si të ardhur të shtyrë e cila njihet si e ardhur në një mënyrë sistematike dhe racionale gjatë jetës së dobishme të aktivitetit.

Vlera e të hyrave të shtyra nga grantet (detyrimet ndaj grantit) e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar 2021 ishte 19,791,975€ ndërsa sipas shënimeve analitike të vlerës së mbetur të pasurive dhe investimeve në vijim të përfituara nga grantet ishte 19,833,335€, pra ekziston një diferencë prej 41,360€.

Kjo diferencë ishte rezultat i saldove të bartura prej viteve të kaluara, dhe gjatë kohës së ekzekutimit të auditimit zyrtarët e kompanisë nuk ishin në gjendje të dokumentojnë se cila ishte vlera e saktë e granteve.

Kjo diferencë kishte rrjedhur nga saldot e bartura prej viteve të kaluara, dhe gjatë kohës së ekzekutimit të auditimit zyrtarët e kompanisë nuk ishin në gjendje të identifikojnë se cila ishte vlera e saktë.

Ndikimi Mospërputhjet e tilla mund të shfaqin pasaktësi në prezantimin e detyrimeve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar.

Rekomandimi A4 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për identifikimin e këtyre diferencave dhe të bëhen korrigjime adekuate në kontabilitet.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A5 - Mbivlerësim i të ardhurave

Gjetja Sipas SNK 18 Të ardhurat, paragrafi 14 përcakton se: Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve do të njihen kur të plotësohen njëkohësisht të gjitha kushtet vijuese (ndër të tjera): është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin do të hyjnë në njësinë ekonomike; dhe shuma e të ardhurave mund të matet në mënyrë të besueshme.

Gjatë vitit 2021 Hidroregjioni Jugor kishte paguar taksa në vlerë prej 32,045€ ndaj përmbauesve, dhe vlerën prej 27,157€ e kishte njohur gabimisht në kontabilitet si të hyrë të vitit. Taksat e përmbauesit janë të rimbursueshme në rast se lëndët e dërguara në përmbaerim arrijnë të përmbaerohen në interes të kompanisë. Prandaj, në rastin konkret lëndët janë në procese përmbaerimore dhe ende nuk janë të përfunduara për t'i njohur si të hyra në regjistrimet kontabël.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Kompania ka aplikuar regjistrime të gabuara kontabël duke njohur aktivet e kushtëzuara si e ardhur e vitit, ende pa u plotësuar kushti për një veprim të tillë.

Ndikimi Regjistrimet jo adekuate në kontabilitet kanë ndikuar që të ardhurat e vitit 2021 të jenë të mbivlerësuara për 27,157€, dhe rrjedhimisht ka mbivlerësuar edhe përlllogaritjen e TVSh-së në shitje për 4,888€.

Rekomandimi A5 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë veprimet e nevojshme për të bërë korrigjimet adekuate në kontabilitet, dhe njohja e të hyrave të bëhet vetëm pasi që lënda të jetë përfunduar.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A6 - Njohja e obligimeve në periudhën e gabuar**

Gjetja Sipas SNK 1, Paraqitja e Pasqyrave Financiare, paragrafi 25 përcakton se: Një njësi ekonomike duhet të përgatisë pasqyrat e saj financiare, me përjashtim të informacionit lidhur me fluksin monetar, duke përdorur kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.

Kompania gjatë muajit janar 2022 kishte pranuar një faturë në vlerë prej 9,370€ që paraqet zbritjen tregtare për shpenzimet e telefonisë mobile të muajit dhjetor 2021. Kjo zbritje tregtare nuk ishte regjistruar në kontabilitet në periudhën e duhur dhjetor 2021, por ishte regjistruar në janar 2022.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i trajtimit të gabuar kontabël sepse një zbritje në faturën e datës 06.01.2022 prej 9,370€ nuk ishte regjistruar në periudhën përkatëse të cilës i përkiste (dhjetor 2021).

Ndikimi Mos regjistrimi i zbritjes së lejuar ka ndikuar që llogaritë e pagueshme të vitit 2021 të jenë të mbivlerësuar për shumën 9,203€.

Rekomandimi A6 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë marr veprimet e nevojshme për të bërë korrigjimet adekuate në kontabilitet për llogaritë e pagueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja A7 - Trajtimi i gabuar kontabël i donacioneve**

Gjetja Vendimi Shpjegues Publik nr. 04/2016 Trajtimi i Donacioneve për qëllime tatimore përcakton se: Projektet e financuara nga të ardhurat e donacioneve, sipas nenit 33, paragrafit 3 dhe nën paragrafit 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSh) trajtohen si transaksione të eksporteve, për të cilat furnizuesi i mallrave/shërbimeve, do të faturojë pa TVSh me të drejtë të zbritjes së TVSh-së së zbritshme. Implementuesi i projektit, për të gjitha blerjet e mallrave/shërbimeve të parapara me projekt, lirohet direkt nga TVSh në blerje, nëse blerjet e tilla bëhen nga të ardhurat e donacioneve.

Hidroregjioni Jugor kishte realizuar 3 projekte në rrjetin e ujësjellësit në regjionin e Prizrenit përmes donacioneve nga komuna e Suharekës dhe Komuna e Prizrenit. Ne gjatë auditimit kemi vërejtur se Hidroregjioni nuk i kishte regjistruar siç duhet 4 fatura që ishin realizuar nga projektet e tilla. Vlera e faturave ishte 109,176€.

Ne kemi vërejtur se Kompania kishte aplikuar regjistrime të gabuara kontabël duke njohur pjesën e TVSh-së së këtyre faturave si e ardhur e vitit, në vend se e gjithë vlera e faturave të njëjtit si detyrim ndaj grantit. Vlera e TVSh-së e njohur si e ardhur e vitit ishte 16,654€.

Kjo kishte ndodhur për shkak se Kompania kishte aplikuar regjistrime jo adekuate duke njohur vlerën neto të faturave si e hyrë e shtyrë (detyrimet ndaj granteve) ndërsa pjesën e TVSh-së si e ardhur e vitit.

Ndikimi

Regjistrimi i gabuar kishte ndikuar që ardhurat e vitit 2021 të jenë të mbivlerësuara për 16,654€ dhe rrjedhimisht ka nënvlerësuar detyrimet-të hyrat e shtyra për të njëjtën vlerë.

Rekomandimi A7

Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se do të bëhen korrigjimet adekuate në kontabilitet dhe në rastet e financimit të projekteve nga donacionet të merren në konsideratë kërkesat ligjore si dhe të zbatohen kërkesat e SNK-ve në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Llogaritë e arkëtueshme

Vlera neto e llogarive të arkëtueshme, e prezantuar në PFV ishte 4,850,976€. Ato kanë të bëjnë me arkëtimet ndaj klientëve nga afarizmi i rregullt i Kompanisë. Ne kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë bruto 694,987€.

Çështja A8 - Parashkrimi i borxheve të konsumatorëve

Gjetja Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve, neni 360 paragrafi 1 përcakton se shërbimet e ujësjellësit për konsumatorët shtëpiak-amvisëri janë kërkesa që parashkruhen pas një viti, ndërsa neni 355 përcakton se: Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer.

Sipas shënimeve të siguruara nga zyra ligjore, Kompania kishte bërë 38 kërkesa ndaj klientëve në vlerë totale prej 63,188€. Këto kërkesa ishin proceduar tek përmbauesi e të cilat nga palët ishin prapësuar në gjykatë, dhe gjatë vitit 2021 me vendim të formës së prerë të gjykatës, vlera e borxhit prej 52,407€ ishte parashkruar apo 83% e borxhit të kontestuar. Më tutje, sipas të dhënave në sistemin e faturimit, kërkesat ndaj konsumatorëve ishin gjithsej 12,115,693€. Prej tyre 9,332,797€ ishin kërkesa më të vjetra se një vit dhe të cilat mund të jenë subjekt i parashkrimit po që se nuk merren veprime të shpejta për parandalim të parashkrimit.

Parashkrimi i lëndëve kishte ardhur për shkak se Kompania nuk kishte ndërmarrë hapat ligjor me kohë për të parandaluar parashkrimin e borxheve. Tjetër faktor me rëndësi që ka ndikuar që borxhet të parashkruhen është se, pagesat e realizuara nga konsumatorët në sistemin e faturimit nuk identifikohen me faturat përkatëse, por ato zbriten nga borxhi i përgjithshëm, gjë që e pamundëson identifikimin e borxhit të vjetër dhe atij që nuk është subjekt i parashkrimit.

Ndikimi Mos marrja e veprimeve ligjore me kohë për ndalimin e parashkrimit të borxheve ndikon drejtpërsëdrejti në zvogëlimin e të ardhurave për Kompaninë duke minuar realizimin e objektivave të saj.

Rekomandimi A8 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që Kompania po ndërmerr me kohë veprimet ligjore që parandalojnë parashkrimin e borxheve dhe të intervenojë në sistemin e faturimit ashtu që faturat e paguara dhe ato të pa paguara të jenë të identifikueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PFV-të të vitit 2020 të KRU Hidroregjioni Jugor kishte rezultuar në 3 rekomandime. Kompania kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2021, 3 rekomandimet ishin zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shih Tabelën e rekomandimeve nr. 1.

Grafiku 1. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 1 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2021

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2020	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për opinion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të bëhen korrigjimet e nevojshme të gabimeve të cilat kanë ndodhur me rastin e trajtimit të pasurive pas rivlerësimit të tyre, në mënyrë që vlera e pasurive të jetë e prezantuar saktë në pasqyrat financiare.	Kompania kishte kryer korrigjimet e nevojshme në lidhje me kalkulimin e saktë të zhvlerësimit të aseteve pas rivlerësimit dhe efekteve në vlerën neto të pasurive dhe shpenzimeve për vitin	I zbatuar
2.	Baza për konkluzion	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, që të merren veprime korrigjuese për njohjen dhe regjistrimin e efekteve të rivlerësimit për të hyrat nga grantet dhe subvencionet në mënyrë që shuma e prezantuar në pasqyrën e të ardhurave të jetë e saktë.	Kompania kishte ndërmarrë veprimet e nevojshme korrigjuese për njohjen e saktë të hyrave nga donacioni.	I zbatuar
3.	Detyrimet afatshkurta	Bordi i Drejtorëve të sigurojë, krijimin mekanizmave adekuate që në periudha të rregullta kohore të bëhen harmonizimet me kartelat me secilin furnitorë në mënyrë që vlera e detyrimeve të prezantohet saktë në PFV.	Nga konfirmimet e pranura nuk kemi vërejtur pasaktësi në saldon e llogarive të pagueshme tregtare.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Qerkin Morina, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Mehmet Mucaj, Drejtor i Auditimit



Naim Neziri, Udhëheqës i ekipit



Alban Shatri, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Komentet e NP-së në gjetjet e raportit të auditimit

Çështja	Komenti i NP-së	Pikëpamja e ZKA-së
Mos përputhje e detyrimeve tatimore në regjistrat kontabël të Kompanisë me gjendjen në ATK	<p>Konsiderojmë se kemi vepruar drejtë duke u bazuar në:</p> <p>1-Memorandumi i mirëkuptimit mbi TVSH në mes të KRU HRJ dhe Ministrisë së Financave 01.09/2008</p> <p>2-Vendimi shpjegues publik nr. 1/2012 datë 01.03.2012</p> <p>3-Vendimi shpjegues publik 02/2013 datë 10.06.2015</p> <p>4. Raporti i kontrollës ATK datë 26.06.2019 faqe 7,8,9.</p> <p>Shuma e TVSH 1,496,887€ është si rezultat i zbatimit të këtyre marrëveshjeve dhe vendimeve.</p> <p>Për shkak të vështirësive financiare të NP që TVSH të paguhet në faturim, NP kanë paguar TVSH në inkasim, pjesa tjetër e pa paguar e faturimit është prezantuar në rubrikën nr.10 të formularit të TVSH për çdo muaj, dhe e prezantuar në ATK (shih vendimin shpjegues). Pasi që kjo shumë është e lidhur edhe me LL.A, do të qëndroj si e tillë derisa të bëhet arkëtimi i këtyre LL.A.</p> <p>Ne nuk kemi mundur t'i heqim nga evidenca kontabël pa një vendim Gjykatë apo vendim të Aksionarit (Qeveria e Kosovës - Ministria përkatëse).</p> <p>Kjo shumë ka qenë e prezantuar edhe në pasqyrat Financiare të viteve (2018, 2019 dhe</p>	<p>Komenti lidhur me çështjen është i pa saktë. Kompania që prej përfundimit të marrëveshjes me ATK në vitin 2015 nuk kishte ndërmarrë veprimet e kërkuara ndaj konsumatorëve që nuk paguajnë borxhet, si dhe nuk kishte bërë rregullimet përkatëse në deklaratën e TVSh-së për rastet tjera për të cilat nuk janë zbatuar dispozitat e borxhit të keq.</p> <p>Në bazë të "Vendimit shpjegues 02/2013 - Shuma e tatueshme në furnizimet me TVSh për ndërmarrjet publike", KRU Hidroregjioni kishte hyrë në marrëveshje 18 mujore me ATK-në për deklarimin dhe pagesën e TVSH-së në inkasim dhe jo faturim ku sipas këtij vendimi në faqen 2, kërkohej që pas përfundimit të marrëveshjes kompania detyrimisht duhet që të zbatoj dispozitat e borxhit të keq në ato raste në të cilat konsumatorët nuk paguajnë faturat e tyre. Më tej, në vitin 2019 pas kontrollës së ATK-së kompania ishte gjobitur edhe për mos veprim pas përfundimit të marrëveshjes, ku kompania as nuk kishte zbatuar dispozitat e borxhit të keq por as nuk kishte kryer rregullimet e nevojshme për njohjen e detyrimeve të TVSh-së si shitje e tatueshme me normat aktuale ligjore.</p>

	<p>2020) për të cilën nuk na është rekomanduar nga ana ZKA në raportet e auditimit të veçohet ndryshe.</p>	<p>Sipas Raportit të Ri kontrollës nga ATK të datës 26.06.2019, në faqen 7, theksohet se pas përfundimit të marrëveshjes në periudhën e parë tatimore është dashur të kryhen rregullimet për aspektin e TVSh-së në mënyrë që të “gjitha shumat e faturuara dhe të pa inkasuara” (nëse nuk janë trajtuar si borxh i keq paraprakisht) të deklarohen në rubrikën përkatëse të deklaratës se TVSH-së si “shitje të tatueshme me normat aktuale ligjore”</p>
--	--	--

<p>Mungesa e politikave të qarta dhe analizave të mjaftueshme për lejimet ndaj të arkëtueshmeve</p>	<p>KRU HR ka bërë ndër vite provizionimin e LL.A duke u bazuar me sa vijon :</p> <p>1-Udhëzuesin Për Menagjimin e Borxheve në Sektorin e Sherbimit të Ujit nr.01-41/3, datë 26.10/18;</p> <p>2-Ligji nr.05/L-029 për Tatim në të ardhurat e Korporatave;</p> <p>3-Ligji nr.05/L-037 për TVSH</p> <p>Sidomos duke u bazuar:</p> <p>4-Ligji mbi Marëdhënjet detyrimore nr.04/L-077</p> <p>5-sipas SNRF-9 e cekur nga ana e ZKA-së, ne jemi bazuar edhe në përvojen historike të viteve të maparshme.</p> <p>Në raportet e Auditimit 2018, 2019 dhe 2020 ne i kemi paraqitur provizionimet e cekura dhe nuk na është rekomanduar të veprohet ndryshe.</p> <p>Në këtë raport është trajtuar Provizionimi në shumë 541,371€ i LL.A për vitin 2021, i cili përbën listën e saktë të konsumatorëve që nuk kanë paguar mbi 1 vit. Në bazë të analizave tona si menaxhment, kemi konstatuar se po të trajtohen nga ana e gjykatës, duke u bazuar në Ligjin mbi Marëdhëniet Detyrimore, borxhi i tillë do të parashkruhet. Këto janë të prezantuara në pasqyra financiare, të cilat janë diskutuar dhe janë të aprovuara nga ana e Bordit Drejtues në raportin vjetor të KRU-së.</p> <p>Njëherit është marrë vendim për aprovimin e raportit vjetor 2021.</p>	<p>Komenti i menaxhmentit nuk qëndron. Entiteti është i obliguar të përgatit dhe të raportojë pasqyrat vjetore sipas SNK dhe SNRF pavarësisht nëse çështjet në fjalë janë ngritur ose jo nga auditimet e viteve të kaluara. Sa i përket provizionimit të LLA, ndërmarrja nuk ka grupuar klientët në varësi të larmisë së përshtatshme nga përvoja e saj historike e humbjeve të kredisë për segmente të ndryshme të klientëve ashtu siç kërkohet në SNRF 9. Ndërsa, provizionimi sipas metodës të përshkruar në komentin e entitetit - borxhet të cilat kompania konsideron se janë parashkruar sipas Ligji mbi Marrëdhëniet detyrimore nr. 04/L-077 kanë të bëjnë me një trajtim tjetër në kontabilitet e cila njihet si shpenzime të borxhit të keq dhe fshirjen e LLA, ndërsa provizionimi nuk është fshirje e llogarive, por lejime për borxhe të këqija. Pra, entiteti duhet të bëjë dallimin midis këtyre dy koncepteve të cilat nuk janë të njëjta.</p>
---	---	--



KRU Hidroregjioni Jugor sh.a.

Adresa: Wesley Clark p.n., 20000 Prizren - Tel.: 029/ 244 150
e-mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT REGIONALNA KOMPANIJA ZA YODOSNABOEVANIE	
»HIDROREGJIONI JUGOR« SH.A.D.D.	
Nr.	1319
Di.	02.06. 2022
PRIZREN	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2021 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e Pasqyrave Financiare të KRU Hidroregjioni Jugor sh.a për vitin 2021;
- pajtohem me disa të gjeturat dhe rekomandimet tuaja, në përjashtim të disa të gjeturave dhe rekomandimeve të tjera, për të cilat kemi dhënë komentet tona në shtojcen I Qështja A1 dhe Qështja A2.
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Zenel Zenelaj, Kryeshef Ekzekutiv në KRU Hidroregjioni Jugor.

.....



Data: 02.06.2022.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante.
- ² Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

K. R. U. " HIDROREGJIONI JUGOR " SH.A.

Pasqyra e pozitës financiare
më 31 dhjetor 2021

	Shënimi	2021 €	2020 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	1,349,695	414,080
Investimet financiare afatshkurtra			-
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	5	4,850,976	5,334,539
Stoqet	6	601,693	617,408
Pasuritë e tjera afatshkurtra	7	10,161	9,552
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		6,812,525	6,375,578
Pasuritë afatgjata			
Investimet në pjesëmarrje		-	-
Investimet në filiale		-	-
Investimet financiare afatgjata - objekte ndertimore	8	2,837,807	2,936,508
Prona, pajisjet dhe impiantet	8	1,320,883	1,435,182
Prona investuese -tokat	8	2,956,300	2,956,300
Investimet në vijim	8	12,660,602	6,080,587
Pasuritë e paprekshme	8	84,967	98,645
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata	8	13,038,352	13,714,948
Gjithsej pasuritë afatgjata		32,898,911	27,222,170
Gjithsej pasuritë		39,711,436	33,597,748
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare			-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	9	2,641,135	2,464,880
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër	10	3,997	18,760
Interesi i pagueshëm			-
Tatimi në fitim i pagueshëm			-
Provizionet afatshkurtra			-
Detyrimet ndaj lizingut, pjesa afatshkurtër			-
Detyrimet e tjera afatshkurtra (detyri. ndaj kons.ne parapagim)	11	83,729	54,503
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		2,728,862	2,538,143
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	12	8,186	8,186
Provizionet afatgjata			-
Detyrimet ndaj lizingut, pjesaafatgjatë			-
Detyrimet e shtyra tatimore	13	1,522,763	1,732,380
Detyrimet e tjera afatgjata	14	19,791,975	13,547,095
